

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Ne ofrojmë shërbim cilësor për bizneset e mesme dhe të mëdha si dhe për ata individë që zgjedhin të kursejnë me ne. Në veprimet tona, ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën në komunikimin me klientët, nuk promovojmë kredinë konsumatore, përpiqemi të minimizojmë ndikimin tonë negativ në mjedis dhe ofrojmë shërbime financiare të përshtatshme me situatën e klientëve tanë si dhe të bazuara në një analizë të përgjegjshme financiare. ProCredit Bank Shqipëri është pjesë e grupit ndërkombëtar ProCredit, me qendër në Frankfurt, Gjermani.

Kerkojme të rekrutojmë se jashtmi, një staf suport në pozicionin :

Specialist në Funksinin e Sigurise Fizike

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Përcakton masat që duhen marre për sigurinë dhe mbrojtjen elektronike të bankes, njesive të biznesit, ATM dhe objekteve duke zbatuar përcaktimet për mbrojtjen elektronike në standartet e sigurisë fizike si dhe udhëzimet e bankes.
- Përgatit projektet e sigurisë dhe mbrojtjes elektronike të objekteve të reja, objekteve në rikonstruksion, në planimetritë e miratuara, duke përcaktuar dhe koston e sistemit elektronik, për:
 - ✓ sistemin televiziv me qark të mbyllur (CCTV)
 - ✓ sistemin e alarmit dhe njoftimit
 - ✓ sistemin elektronik të MNZ
 - ✓ sistemin e hyrjeve të kontrolluara me kartë elektronike.
 - ✓ Sistemin e mbrojtjes së ATM-ve off dhe in site.
 - ✓ Sisteme të tjera të nevojshme
- Përcakton planimetritë e objekteve të reja dhe të rikonstruara, pozicionet e instalimit të elementeve të mbrojtjes elektronike sipas sistemeve përkatëse
- Mbikqyr kryerjen e punimeve instalative të kompanive të kontraktuara për implementimin korrekt të sistemeve të sigurisë sipas projektit të përgatitur.
- Përgatit praktiken e nevojshme dokumentare për mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes elektronike.
- Ndjek aktmarreshjet për mirëmbajtjen periodike dhe emergjente të sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes elektronike dhe instalimin e sistemeve të reja.
- Kontrollon në vazhdimësi funksionimin e sistemeve elektronike dhe përgatit praktikën e nevojshme dokumentare për riparimin e defekteve.
- Përgjegjës për funksionimin e Qendres së Sigurisë, funksionimin e aparaturave të instaluara, mbulimin e shërbimit nga operatorët, dërgimin e sinjaleve të alarmit në Sallen Operative të kompanisë së kontraktuar.
- Ben programimin e sistemeve elektronike, instalimin dhe riparimin e paisjeve të mbrojtjes elektronike të instaluara në objekte në zbatim të marrëdhënieve kontraktore.
- Përgjegjës për paisjen me kode alarmi dhe aplikacione të tjera të sigurisë elektronike dhe CCTV-së punonjësit në banke dhe njesitë e biznesit, në zbatim të Procedurave dhe Standarteve të miratuara për këto qëllime.
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga mbikqyresja e drejtperdrejtë

Nëse eksperiencia dhe profili juaj korrespondon me kërkesat e mëposhtme:

- Preferohen kandidatët me eksperiencë në pozicione të ngjashme
- Diplome Universitare
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe organizative
- Të jete proaktiv dhe fleksibel për të punuar jashtë orarit zyrtar
- Aftësi të mira në gjuhën angleze

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj brenda datës **29 shtator 2016** duke klikuar në linkun: [Apliko këtu](#)

Vetëm kandidatët që do të përzgjidhen do të kontaktohen nga Njësia e Burimeve Njerezore për tu ftuar në fazat e tjera të rekrutimit.

